



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS
NË KONFERENCËN E 10 NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË
RESTAURUESE
14 qershor 2018**

E nderuar zv/kryetare Hysi,
E nderuar ministre Gjonaj,
Zonja dhe zotërinj!

Kam kënaqësinë të marr pjesë në këtë konferencë ndërkombëtare kaq të rëndësishme për drejtësinë restauruese. Prezenca e OSBE-së këtë përpjekje shumëdimensionale.

Drejtësia restauruese luan rol të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë penale. Drejtësia restauruese është një qasje për zgjidhjen e problemit, që përfshin viktimën, autorin e veprës penale, rrethin shoqëror të tyre, institucionet e drejtësisë dhe komunitetin. Programet e drejtësisë restauruese bazohen në parimin themelor se sjellja kriminale është jo vetëm shkelje e ligjit, por është edhe dëmtim i personit, viktimës, dhe komunitetit. Në çdo përpjekje për të trajtuar pasojat e sjelljes kriminale duhet që, aty ku është e mundur, të përfshihet edhe autori i veprës penale, edhe palët e dëmtuara, duke ofruar njëkohësisht ndihmë dhe mbështetjen e duhur për viktimën dhe autorin.

Znj. Zëvendëskryetare e Kuvendit, më la shumë mbresa ajo që thatë për nevojën për drejtësi restauruese. Prezenca e OSBE-së e ka mbështetur Shqipërinë në këtë fushë. Partneriteti ynë me një gamë të gjerë aktorësh të drejtësisë i mundëson Prezencës që, me mbështetjen që i jep reformës në drejtësi, ta shohë situatën nga disa këndvështrime. Reforma në drejtësi duhet të gjetë gjithëpërfshirëse për të qenë e efektshme. Ligjet dhe strukturat po reformohen, dhe nuk duhet të harrojmë se suksesi i reformës kërkon së pari miratimin e masave që rrisin besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka kontribuar në reformën në drejtësi në dy drejtime: me mbështetjen për reformën ligjvënëse, dhe me kontribut konkret në ndërmjetësimin mes viktimave dhe autorëve të veprave penale.

Që në vitet 2014-2015, ne mbështetëm ndërmjetësimin viktimë-autor në Shërbimin e Provës. Ky shërbim ndërmjetësimi i ofruar nga Fondacioni Shqiptar për Zgjidhjen e Konfliktëve dhe Pajtimin e Mosmarrëveshjeve ka qenë i suksesshëm në 81 nga 92 raste, që do të thotë në 88% të të gjitha rasteve të referuara për ndërmjetësim nga Shërbimi i Provës. 57% e personave të përfshirë ishin të mitur dhe të rinj. Por, çfarë do të thotë kjo konkretisht? Kjo do të thotë se në 88% të të gjitha rasteve, është arritur një marrëveshje ndërmjetësimi mes autorit të veprës penale dhe viktimës. Ky është një sukses mbresëlënës.

Kjo do të thotë se ndërmjetësimi ka ndihmuar në rehabilitimin dhe riintegrimin e autorëve të veprave penale, duke ndihmuar rrjedhimisht edhe në uljen e sjelljeve kriminale. Më tej, kjo ka lehtësuar barrën e gjykatave dhe ka ulur mbipopullimin në burgje. Aktualisht, mbipopullimi llogaritet në mbi 250 persona ose 5% e tërë popullatës së burgjeve. Në të njëjtën kohë, më lejoni të theksoj një aspekt shumë të rëndësishëm dhe risinë e këtij ndërmjetësimi: ai u jep mundësinë viktimave që të dëgjohen, mundësinë që shqetësimet dhe frika e tyre të trajtohet.

Tani është koha që të hidhen hapat e mëtejshëm. Duhet të merren masa që ndërmjetësimi në çështjet penale të jetë shërbim përgjithësisht i mundshëm në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale, sidomos për të miturit. Duhet të ketë konsultim sistematik ndërmjet autoriteteve të drejtësisë penale dhe shërbimeve të ndërmjetësimit, me qëllim konsolidimin e praktikave dhe terrenit të përbashkët.

Të gjithë presim rekomandimet tuaja. Faleminderit shumë dhe ju uroj diskutime të suksesshme dhe sa më frytdhënëse. Faleminderit!